



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inistranin Poslova i Diaspore –

Ministry of Foreign Affairs And Diaspora

Ambasada e Republikës së Kosovës në Berlin

K O N K U R S

Për vend të lirë pune:

Pozita: Punonjës Sigurimi
Vendi i punës: Ambasada e Republikës së Kosovës në Berlin-Gjermani
Kohëzgjatja e kontratës: Një vit (me mundësi vazhdimi) me një periudhë provuese prej 3 muajsh
Data e aplikimit: (22/08 – 5/09 2022)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e Shefit të misionit, kryen detyrat si më poshtë:

- Kryerja e funksioneve rutinore të Sigurisë;
- Siguria e Objektivit të Ambasadës-Konsullatës, transportit të mallrave dhe ngarkesa të tjera.
- Siguria dhe mbajtja e rendit me palë pranë Ambasadës-Konsullatës.
- Mbajtja e librit të shënimeve për hyrje-dalje, si dhe dokumentacione të tjera.
- Në raste të caktuara, kryerja e detyrave të tjera zakonisht të caktuara për Asistentin Administrativ.
- Puntori i sigurisë duhet të jetë në gjendje që të kryej mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta të Objektivit .
- Të jetë në gjendje që menjëherë pas thirrjes nga Ambasadori/Shefi i Misionit ose zyrtari kryesor konsullor të ofrojë mbështetje për Siguri për detyra zyrtare në mbrëmje ose gjatë fundjavës.
- Të jetë në dispozicion për vizita zyrtare 24 orë.

Kriteret dhe kushtet e nevojshme

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme;
- Te jetë shtetas i Republikës së Kosovës (me qëndrim të rregulluar në shtetin pranues) apo shtetas i shtetit pranues;
- Të ketë njohuri të gjuhës Gjermane të shkëlqyer, preferohet edhe njohja e gjuhës Angleze .
- Aftësia e dëshmuar për sistemimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit, përcaktimin e zgjidhjeve të duhura;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë në gjuhët Gjermane preferohet edhe gjuha Angleze;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme të vet-organizimit, të jetë në gjendje që të krijojë përparësi në mënyrë efektive duke punuar në një ambient nën presion;
- Të ketë 3 vjet përvojë relevante të punës.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet ti plotësojnë këto kushte, për të hyrë në rrethin e ngushtë dhe pastaj për tu intervistuar.

- CV-në
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjet e kualifikimit-diplomës; për intervistë Diplomen Originale
- Dy referenca të punës dhe një letër motivuese;
- Certifikatën nga mjeku për gjendjen shëndetësore;
- Certifikatën se nuk jeni nën hetime nga autoritetet e shtetit pranues;

Këto dokumente mund të dërgohen përmes postës në adresën Botschaft der Republik Kosovo „Koenigsallee 20A/20B, 14193 Berlin“ ose përmes e-mailit embassy.germany@rks-gov.net

Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen.